UDHËZIM
Nr.4, datë 19.1.2009

PËR PËRCAKTIMIN E FONDIT TË NGURTËSIMIT PËR GARANCINË E FITUESIT/FITUESVE NË LOJËRAT E FATIT

(*Ndryshuar me udhëzimin nr. 19, datë 17.6.2013*)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 42 të ligjit nr.10033, datë 11.12.2008 "Për lojërat e fatit",

UDHËZOJ:

Organizatorët e lojërave të fatit, për garantimin e fituesit/fituesve të lojërave të fatit, duhet të ngurtësojnë në një llogari të veçantë bankare, një shumë të caktuar si më poshtë vijon:

1. Për çdo sallë bingo, organizatori duhet të garantojë, për çdo lojë, fituesin/fituesit e lojërave të fatit, me kapitalin themeltar të shoqërisë, si dhe me fondin e ngurtësimit:

a) Për sallat në rrethet e kategorisë së parë, në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë;

b) Për sallat në rrethet e kategorisë së dytë, në masën 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

c) Për sallat në rrethet e kategorisë së tretë, në masën 1 000 000 (një milion) lekë.

Organizatori mund të kërkojë çngurtësimin e pjesshëm për shumën e fondit të garancisë për fituesit, në përputhje me përkatësinë e sallës me njërën nga kategoritë e parashikuara në pikat "a", "b" apo "c".

2.Për bastet sportive dhe baste për gara në pistë:

a) Organizatori të garantojë për çdo lojë, fituesin/fituesit e lojërave të fatit, me kapitalin themeltar të shoqërisë, si dhe me fondin e ngurtësimit në masën 7 000 000 (shtatë milionë) lekë.

3.Për lotarinë kombëtare dhe për kazinotë:

a)Organizatori të garantojë për çdo lojë, fituesin/fituesit e lojërave të fatit, me kapitalin themeltar të shoqërisë, si dhe me fondin e ngurtësimit në masëm 20 000 000 (njëzet milionë lekë).

4.Për kazinotë elektronike, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo makinë elektronike, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë. *Për kazinotë elektronike në distancë, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 200 000 000 (dyqind milionë) lekë.*

5.NJMLF-ja i propozon Ministrit të Financave zhbllokimin e këtij fondi, me kërkesë të organizatorit të lojërave, në rast se vërtetohet se ky i fundit nuk ka detyrime tatimore, nuk ka gjoba të pashlyera, si dhe kur mbyll veprimtarinë e tij, të vërtetuara këto nga organet shetërore përkatëse. *Në rast se shoqëria, edhe pse e ka bllokuar fondin e garancisë, nuk është pajisur me leje, zhbllokimi i këtij fondi bëhet nga Ministri i Financave pas propozimit të NJMLF-së.*

6.Ngurtësimi duhet të jetë në formën e garancisë bankare të pakushtëzuar. *Për kazinotë elektronike në distancë, garancia duhet të jetë sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi si pjesë përbërëse e tij.*

Ky urdhër hyn në fuqi me botimin e Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode